EJA KRAHËHAPUR **Berzat Sadiki**

Boton:
Shoqata e shkrimtarëve PRO LITERA
Rr. 167, nr. 6, Tetovë 1200
Republika e Maqedonisë së Veriut
shoqataprolitera@gmail.com

Redaktor: **Berzat Sadiki**

Recensenti, lektori,
përpunimi teknik:
PRO LITERA

Shtypi: Art grafik, Tetovë

Tirazhi: 500 kopje

Berzat Sadiki

EJA KRAHËHAPUR

poezi

PRO LITERA
2025 Tetovë

DO TË SHFAQET

E vërteta do të mbijë,
sikurse mbijnë lulet.
E vërteta do të rrjedhë,
sikurse rrjedhin lumenjtë.
E vërteta do të ndriçojë
sikurse dielli agimeve.
E vërteta do të zgjohet
sikurse luleborat.

E vërteta do të shtegtojë
sikurse dallëndyshet.

E vërteta do të ngjyroset
sikurse ylberet.

E vërteta do të përhapet
sikurse shirat pranverorë.
E vërteta do të këndohet
sikurse kënga e zogjve.

E vërteta ka rrënjë të thella.
Deshëm apo s'deshëm,
kurdo do të shfaqet,
sikurse pema majë shkëmbi.

RIMAT DIELLORE

Këto rima janë diellore -
në gjiithë botën të ketë liri;
të kapen popujt dorë për dore,
për paqe dhe për dashuri.

Njeriu të bëhet shpend,
të fluturojë pa kufi;
mbi fusha, male dhe oqeane -
ku do të ketë fole - shtëpi.

Njerëzimi të bëhet një,
të lidhë besë dhe miqësi;
ligësinë bashkë ta çrrënjosin,
të mbjellin gëzime dhe lumturi.

AH, SA DUA

Dua të flas për të bukurën,
ditë e natë sa e kujtoj;
por, a më tregoni, si të flas,
kur atë, sa rrallë e takoj?

Ndonjëherë shtirem dhe gënjej,
bukurinë e imagjinoj;
shkruaj për skena mirësie,
se pa shpresë s'mundem të rroj.

Vërtet, vlerat janë braktisur,
pa to s'ka jetë dhe lumturi;
si mund të vijë përparimi,
pa edukatë, pa dituri?

Ah, sa dua dhe sa përpiqem,
të ngadhënjejë drejtësia;
bota të jetojë e lirë,
të përhapet dashuria.

FLISNI PËR DASHURI

Më të mirë janë ata njerëz,
që askënd s'e shqetësojnë,
askënd s'e përbuzin.
Këta janë përplot ndjenja gazmore
dhe këto gazmende
i shpërndajnë te të tjerët.

Kush e ka këtë edukatë,
është vërtet njeri.

Lumët ata
që kanë në zemrat e tyre dashuri
dhe këto dashuri ua duan edhe të tjerëve!

Flisni para njerëzve drejtë
dhe gjithnjë flisni të vërtetën!
Nëse këto nuk janë te ju,
më mirë të mos flisni,
sepse prishet respekti, dashuria
dhe afërsia mes jush!

Gojë e ëmbël është ajo gojë,
e cila ëmbëlton.

Doni njëri-tjetrini,
që midis jush të vijë dashuria,
mençuria, lumturia, paqja dhe liria!

Pa dashuri mes njëri-tjetrit
jeni në mjerim,
jeni në trishtim
dhe në vetërobërim.
Me këto tipare të ulëta
do të armiqësohi mes jush.
Do të bëhi e keqja e juaj,
do të bëhi gazi i botës.

MA TRAZOJNË SHPIRTIN

Ditët dhe netët kalojnë.
Ikin sikur puhizat në pakthim.
Pse kaq jetë të shkurtër bëjnë fluturat?

Kalojnë stinët.
E braktisin njëra-tjetrën.
Lulet bëhen kokrra.
Bletët vdesin ndërkohë.
Këto përjetime ma trazojnë shpirtin.

Hapësira ndriçohet dhe errësohet.
Nata e lind ditën, dita e lind natën.
Ndahen nga njëra-tjetra.
Vallë, ku shkojnë këto?
Ditët dhe netët e kaluara nuk zhduken.
Ato ruhen në ndonjë sirtar të posaçëm.

Luftrat vazhdojnë pandalshëm.
Çdoherë i keqi e vret të mirin.
Kjo është e ditur, e qartë.

Nata ndër stinë ndërron,
herë më e gjatë e herë më e shkurtër.
Për kënd ndërrohen këto?
Edhe koha qenkësh në rrugëtim.

Këto përjetime ma trazojnë shpirtin.
E kujt është koha?
Cilëve u përket?
A ka dikush që e përvetëson?

Ne mund të jemi vezullim dhe fat i mirë.
Mund të jemi hallka dashurie,
por mund të jemi edhe rrufeja,
që i godasin dashuritë.
Mund të jemi edhe shigjeta që shpojnë zemra.
Këto përjetime ma trazojnë shpirtin.
Unë nuk jam shkaktar i rrufeve,
as shigjetë që vras.

Fluturat vijnë e shkojnë.
Pse vijnë fluturat?
Lulet çelin lule.
Lulet nuk vijnë vetvetiu.
Po ç'ndodh me xixëllonjat?
Këto përjetime ma trazojnë shpirtin.
Ndoshta jemi vetëm vezullime.
Ndriçojmë e fikemi,
vijmë e shkojmë.
Kush jemi ne?

Këto përjetime ma trazojnë shpirtin.
Kujtoj se nuk jam rastësi.

Kur vijmë në këtë botë, vëmë emra.
I regjistrojmë në dosjet e ofiqarëve.
Na caktohet numri amzë.
Kur shkojmë, nuk shkojmë kot.
Shpirtrat palosen diku në ndonjë sirtar.
Rastësia nuk ekziston.
Këto përjetime ma trazojnë shpirtin.

HYNI KU UA DO ZEMRA

E vërteta është e vërtetë.
ajo nuk mbyllet me beton,
as me perde, po as me fjalë.

Përballë të vërtetës është injoranca.
Janë dy pole të kundërta.
Janë si nata e dita.

Janë dy dyer:
e xhenetit dhe e xhehenemit.
Të dyja janë të hapura.
Urdhëroni, hyni!
Hyni te ajo ku ua do zemra!

E vërteta është e vërtetë.
Ajo kurrë nuk ndryshohet.
Nuk ka armë që e vret,
nuk ka fuqi që e zhduk.
Ajo është e përjetshme.

Askush nuk i shpëton vdekjes,
prandaj jetoni si të doni
dhe vdisni si të doni!

KOKA NJERIU, MENDJE DJAJSH

1.
Ky vend, hithrën e quan trëndafil,
bretkosën bilbil.
Në këtë vend,
nëpër zemra u valëvitet flamuri...
flamuri i shkurtpamësisë.

2.
Unë jam algë diellore,
që valëvitet
qiejve të dashurisë.

3.
Shokët dhe miqtë
i shoh të shëmtuar,
të çarë në shtatëdhjetë e shtatë.
E kanë humbur ekuilibrin e mendjes.
Ecin me kokë trotuareve,
jo me këmbë,
këmbët i mbanë lart kah qielli,
që të duken të veçantë,
të dalluar.

4.
Shokët dhe shoqet e mia
e kanë humbur bukurinë.
Kanë marrë pamje lugetësh.
A nuk është ky tmerr?

5.
Unë jam lule trëndafili.
Kam aromë vjollcash.
E kam ndarë kohën në një stinë.
Në stinë hyjnore.

Unë gjendem brenda shpirti,
si guaskë e robëruar
në fund të horizonteve të jetëve.

6.
Unë jam një gjethe pranverore.
Një lule jargavani.

7.
Një pjesë e imja bërtet,
jehon hapësirave të shpirtit.
E kërkon nënën e humbur.
E vajton vajzën e virgjër,
që e dhunuan lugetët.

8.
Këto janë jetë të tmerrshme.
Nënën s'e gjen dot.
Dashuria është fikur.
Fara nuk mbin,
është helmuar me urrejtje,
është goditur me injorancë.

9.
Djalli është çliruar,
njeriu është robëruar.
Jeta ka vdekur,
jeton vetëm ekzistenca e verbër.

NUK GJEJ RRUGË

E kam humbur hartën.
E kam humbur busullën.
Nuk gjej rrugë që çojnë te njerëzit
dhe te njerëzorja.
Nuk gjej rrugë për ta takuar një shok,
një mik a një mikeshë.

Ka rrugë të shumta, nuk numërohen.
Ka rrugë tradhëtarësh,
ka rrugë dinakësh,
ka rrugë mashtruesish,
ka rrugë hajdutësh,
ka rrugë qorre.

Nuk u shpik një mjet a një vegël,
për t'i gjetur rrugët e mia,
prandaj rri i ngujuar.

Nuk gjej shteg,
që nga shtëpia të dal përtej,
të gjej miq të sinqertë, besnikë,
miq pa interese.

KUMTIM PËR DASHURI

Goditni, o ju vetëtima majat!
Përmbysni, o ju valë oqeanesh piratët!
Ndriço, o diell agimet e zeza -
le të prarohet i gjithë njerëzimi me dritë!

Rritu, o diell, mbulo qiellin, bëhu qiell,
që syri i mizorëve të të shohë,
sepse ata s'e shohin dritën!

Mbushu, o qiell me zogj,
zogjtë të bëhen dashuri,
sepse syri i mizorëve s'ka parë liri!

Horizonti le të mbushet me lutje
për mirësi dhe begati deri në qiellin e shtatë!

Të gjithë shpirtmirët t'i drejtohen Zotit për liri,
t'i drejtohen njëri-tjetrit për dashuri!

VJOLLCAT

Vjollcat kanë filluar të shfaqen,
ato i ndiejnë hapat e mi;
njihemi që nga fëmijëria,
dashuria jonë nuk ka kufi.

Për të arritur te të dashurat,
as që më dërgohet ndonjë ftesë;
mjafton ato t'i ruaj në zemër,
që dashuria të mos më vdesë.

Vjollca, o ju vjollca të dashura,
dielli me rreze u përkëdhel;
kur shtrihem barkas dhe u marr erë,
dashuria hap petale dhe çel.

Pranvera e 2025 në Uzurmisht

ÇANTAT TUAJA

Përderisa koha ec, ecni edhe ju!
Punoni, veproni drejtë!
Koha do të ecë gjithmonë,
kurse ju do të ndaleni.

Në ikje,
me vete do ta merrni
vetëm çantën tuaj.
Në çantë,
të rruajtura saktë,
do t'i keni ato që i bëtë gjatë jetës.

Të dhënat e juaja
do të jenë të arkivuara në një paisje
me madhësi të kokrrës së rrushit.

Qofshin dënime, qofshin shpërblime,
do t'i keni në llogarinë tuaj,
në llogarinë përfundimtare,
në kokërr rrushi në vend të sigurtë.

PARA SYVE

Egërsirat e çajnë drenushën
para syve tuaj,
kurse ju shikoni sehir,
dhe në vend që të bashkohi,
përçahi.

Egërsirat e çajnë drenushën
para syve tuaj,
kurse ju zgërdhihi, qeshni,
talleni dhe e urreni njëri-tjetrin.

Përqeshuni, talluni, përçahi...
Kështu u duan egërsirat edhe juve -
të jeni sa më të dobët,
për t'ua futur nofullat
dhe dhëmbët thellë krahërorëve,
zemrave.

TË D0NI

Ta doni dikënd është mirë.
Është shpresë.

Ta doni dikënd që nuk u do,
është zhgënjim,
është mjerim.

Ta doni dikënd që ua kthen me dashuri,
është më mirë se mirë.
Është lumturi.
Është përparim.
Është bashkim.

Të mos e doni dikënd është mjerim.
Është dështim.
Është robëri.

E MAS MËNGJESIN

Sa e dua këtë erë të lehtë që ma rreh fytyrën.
Unë lëviz mbi barin kadife të gjelbërt.
Që të mos ta trazoj nga mbarësia,
Mëngjesine e mas me hapa të kujdeshëm.

I mbylli sytë para diellit dhe i them: - Puthmë!
Pastaj e sodis natyrën thellë.
Për të pikturuar shpirtit,
ia marr pikë për pikë ngjyrat.

Cicërimat e zogjve
më hynë në vesh si ëndërra të këndshme.
Ngjyrat e luleve
m'i përkëdhelin bebëzat e vuajtura.
Fluturat më vijnë përreth
si balerina parajësore.

GJUHA E LUMIT

Dëgjohet rrjedhja e lumit.
Këto janë tinguj hyjnorë.
Është gjuha e tij absolute.

Vë veshin t'i kuptoj tingujt.
Gjë nuk kuptoj, por mrekullohem me këto.
Mrekullimi është shenjë,
që ma thotë pikërisht
se e kam kuptuar gjuhën e tij.

Lumi flet heshtazi:
- Unë ec me durim.
Edhe pse më vrasin gurët,
vetëm ofkëlloj ndër vetvete
dhe vazhdoj të ec pandalshëm.

Më thotë:
- Edhe ty, mik i dashur, të kuptoj.
Sytë tuaj më përkëdhelin.
Prania jote më gëzon
por nuk dua të jesh pranë meje i trishuar!
Trishtimi nuk është për ty!
Bëhu si unë, ec, vazhdo!
Goditjet janë melodia jonë gjatë ecjes.

NËSE DONI

Nëse doni liri,
shkoni ndër ujq.
Ata janë më miqësorë se njeriu!

Nëse doni dashuri,
atë nuk do ta gjeni te njerëzit,
atë e gjeni te kafshët.

Nëse doni paqe,
mos rrini me njerëz!
Shkoni livadheve, lumenjve!

Nëse doni lumturi,
doni prindërit,
doni fëmijët,
doni nipërit dhe mbesat!
Te të tjerët,
do të gjeni sherr,
goditje të rënda shpirtërore
dhe zhgënjim të tmerrshëm.

MIQTË E MIRË

I tha dega bilbilit:
- Do të jemi miq përgjithmonë.

I tha bleta lules:
- Nuk ndahemi kurrë.

Dielli, tha:
- Unë e ndriçoj botën.

Bilbili, foli:
- Unë i këndoj këngët më të bukura.

Një fëmijë, foli:
- Unë jam lule.

KURBETI

A dini ç'është migrimi?
Ai është vetë trishtimi.

Përderisa përpiqen për të jetuar,
jeta u ka mbaruar.

KUJDESUNI PËR MENDJEN

Mirëmbani mendjen!
Kujdesuni për të si kurrkush tjetër!

Mendja është pasuria e vetme,
me të cilën mund ta kaloni
çdo pengesë.

Të tjerët u duan të jeni
sa më budallë.

Të mençurit janë ajka e popullit,
janë diamantë
dhe thesari më i çmuar
i njerëzimit.

Kujdesuni për të mençurit!
Të tillët janë diej të jetës suaj.
Janë shija e jetës,
janë liria, lumturia.

Në shpirt dhe në zemër,
t'u zënë vend të mençurit!
Këto të jenë dëshirat e juaja të para!

Të mençurit t'i doni
më shumë se buka dhe uji!
Për ta të jeni të etur dhe të uritur,
sepse me ta
do ta mbani ekuilibrin e jetës.

Kujdesuni për mendjen
mëngjes e mbrëmje,
mbrëmje e mëngjes,
gjatë gjithë jetës -
ajo është strofulla
dhe pallati më i çmuar
i jetës suaj!

Kujdesuni për mendjen
të mos u krimbet!
Të krimbur u do armiku
dhe satana.

Ju,
të mençurit, bëhuni tok!
Bëhuni bashkë sikur dielli!
Shpërndani mençurinë
sikur dielli rrezet e tij,
në katër anët e botës,
deri në qiell.

Duart tuaja
të bien mbi çdo kokë,
sepse ju jeni magjia,
që e shfaros të keqen,
që e zhduk farën e mjerimit.

Kujdesuni për mendjen!
Atë ua duan mbretërit,
luanët dhe sorrat;
atë ua duan morrat,
horrat;
ua duan të tillë,
që t'ua hanë,
t'ua pinë,
duan të jeni të nënshtruar,
u duan sa më të marrë.

NËPËR TREGJE

Të verbërve,
po t'ua futësh diamantët në sy,
nuk do t'i shohin.
Vlerat për ta janë të padukshme,
s'kanë aftësi për t'i parë.

Verbon injoranca.
Injoranca përbëhet nga lakmitë,
nga lakmia për poste,
për pasuri
dhe për pangopësi.

Në injorancë i paafti ngritet,
hajduti pasurohet,
i padituri merr diplomë,
i paafti punësohet,
i padrejti lartësohet.

Nëpër tregje gjithçka shitet dhe blihet,
pos drejtësisë,
ndershmërisë
dhe meritës.
I drejti, i mençuri, i dituri,
dhe meritori janë kurrkushë.
Janë viktima.

ME GRUSHT E ME ZEMËR
(Për ju e kam dashurinë)

- Si ta mësoj jetën, më thuaj!

- Duaje vetveten ashtu si je
dhe mos i bëj dëm!
Ngjitu asaj, sikur bleta lules!
Lidhu me të, sikur agimi me mëngjesin!

- Si ta mësoj dashurinë?

- Kjo është paksa e vështirë.
Grumbullo fuqi ëndrrash!
Mbylli sytë dhe hape mendjen!
Ngriti duart lart dhe betohu!
Thuaje me fjalë, me zë!
"Unë betohem në dashuri."
"Unë jam me njerëzit e mirë."

- Po e keqja?

- E keqja ekziston, ta dish!
Rri larg saj dhe mos e duaj kurrë,
përpiqu vetëm ta këshillosh!

- Me kënd të jetoj?

- Jeto me dashurinë tënde!
Pastaj, duaj të tjerët me radhë,
sipas dashurisë që ke ndaj tyre.
Duaj me grusht e me zemër,
ua shpërndan sipas meritës.
Ua hedh: - Merrni!

TË VJETRA

Ato, që i thoshte gjyshi, ishin të vjetra.
Ato, që i thoshte baba, ishin të vjetra.
Ato, që i them para fëmijëve të mi,
janë të vjetra.
Edhe ato që fëmijët e mi
do t'ua thonë fëmijëve të tyre,
do të jenë të vjetra.

E reja është jetëshkurtër.
Jeton vetëm disa vjet,
mbetet tregime ndër breza.

DO TË QESHNI NDONJËHERË

Mirë se erdhët në këtë botë,
fyelli në vaje të jehojë;
më mirë e keni të derdhni lot,
sesa pushka juaj të gëzojë.

Vërtet ky dielli do t'u ngrohë,
kjo jetë është me përgjegjësi;
do të qeshni ndoshta ndonjëherë,
nuk është lehtë të jeni njeri.

Po sa e rrejshme është kjo botë,
në gostitje në mjaltë u thërret;
kur i shkoni mysafir në sofër,
ajo ua jep helmin për sherbet.

Kjo botë u ngre aq lart, në mbret,
rrugën me akull kudo ua shtron;
më pas me çekiç kokës u godet,
u hedh në baltë, vetë rri në fron.

Jeta është gjethe, e merr era,
është mollë, që dega e lëshon;
hyni në dimër, s'u pret pranvera,
harrohi, si shiu kur avullon.

XHEPAT E ZEMRËS

Ai i fëmijërisë
është përplot gëzime.
Ai i rinisë
është i mbushur me kujtime.

Xhepi i pjekurisë
është me gëzime dhe trishtime.
Në të ka goditje
po edhe ledhatime.

Ai i miqve dhe shokëve,
i rënduar me përjetime,
ka gozhda, ka gjilpëra
dhe shumë mashtrime.

Ai i gëzimit dhe shpresës
është gjithmonë i hapur.
Në të çfarë hyn,
përgjithmonë është kapur.

BATISËN NË LLAÇ

Ngjitesh nga njeriu në filozof.

E them filozof,
sepse filozof e quaj shejtanin tënd,
i cili të ka marrë në njërin bri,
të ka ngulur në të, sa të hedh përpjetë,
që të dukesh i madh para budallenjve.

Budallenjtë janë shumë.
Presin t'u bësh sehir dhe t'u tregosh
se je shmangur nga orbita e Krijuesit.

Mu sikur ti,
edhe shejtani u bë mendjemadh,
prandaj kaq u bë i famshëm -
u bë simbol i krijesave
të premtuara të xhehenemit.

Pasi do famë, or ti, e paç!
Por, kjo lloj fame
t'i ka hequr brekët e urtësisë.
Ke mbetur cullak para syve hyjnorë.

Mendtë tua batisën në llaç.

MOS MË PYET TANI

Mos më pyet për dashurinë tani,
më pyet në verë!

Mos më pyet për dashurinë tani,
më pyet në vjeshtë!

Mos më pyet për dashurinë tani,
më pyet në dimër!

Mos më pyet për dashurinë tani.
më pyet në pranverë!

Çdo stinë
e ka tregimin e vet
për dashurinë.

Secila dashuri meriton dashuri -
pa kufi.

PA NDARË SHIKIM

Kur rrufetë ta sundojnë qiellin,
kur retë e zeza ta mbulojnë diellin,
kur qielli dhe toka të bashkohen,
kur dita dhe nata të përqafohen -
të jemi bashkë të dashuruar -
me trëndafilë në duar

Kur të zgjohemi në atë agim,
ballëpërballë pa ndarë shikim

DALLGËVE TË DASHURISË

Gjithmonë perlë do të jesh,
në një skaj të zemrës strukur;
le të ndritin yjet mes nesh,
të mbetesh ashtu e bukur!

Dallgëve të dashurisë,
kush ka hyrë, do të mbytet;
kjo botë e çmendurisë,
t'i djeg ditët, javët, vitet.

Kujtimet si vetëtima,
e godasin shpirtin thellë;
zemra shpuar vrima-vrima,
se s'm'u shqepe asnjëherë.

TRËNDAFIL TË MË KESH

Nuk e pe syrin e lënduar,
dhimbjen zemrës së copëtuar;
këto vese vetë m'i mbolle,
në hall të mjerë se ç'më solle.

Sa dua trëndafil të më kesh,
t'më mbajë ajo dega jote;
gjithmonë dashuria të resh.
nëpër stinë e nëpër mote.

Kurrë s'kam rënë në varfëri.
Nuk kam as të tjera dëshira.
E gjithë flaka digjet për ty.

N'sytë e tu fjalë mbolla.
Në kopshte si lule të mira.
Prandaj të quaj, Faqemolla.

25 korrik 2020 në Tetovë

POEZI E PRAPTË

E shoh se njerëzit e vlerësojnë formën,
por jo thelbin.
E vlerësojnë lëvozhgën, jo bërthamën.

E vlerësojnë gojën, jo zemrën.
E vlerësojnë fjalën e rreme.

E vlerësojnë autorin,
jo punën a veprën e tij.
E vlerësojnë karrierën, postin.

E shoh se njerëzit janë të cekët
për ta parë të vërtetën.
Lidhen për interese.

E shoh se njeriu i vlefshëm
nuk kuptohet,
kurse të dobishmet e tij
nuk kanë vlerë.

E kuptoj se jetoj ndër njerëz,
që kushedi në janë njerëz.
Koha ime, o ka kaluar, o do të vijë.
Kushedi.

FOL

Ec mbarë, ec për vete!
Ndrysho botën në të mirë!
E para është fjala -
fjala e drejtë, e mbarë.

Duro dhe këshillo!
Këshillo patjetër!
Këshillo për mbarësi!
Dielli shkon mbarë,
toka sillet mbarë,
kurse njeriun e merr ana.
Shpëtoje!

Fol!
Fol kur duhet!
Fol për mbarësi!
Patjetër!
Fol, fol, e ke obligim!

Kujdes!
Po nuk fole për mbarësi,
po nuk këshillove,
do të shembet jeta.

FLAKËRON DASHURI

Kur ta kuptojnë
se ti je kënaqësi shpirti,
nuk do të ndahen kurrë.

Kur ta kuptojnë
se ti je stuhi e ëmbël,
do të përmendin për të mirë.

Ti je sirenë dashurie,
që e trazon çdo valë shpirti,
që shkakton tërmete.
Tërmete zemrave.

Eja kur të duash!
Ditë e natë je hënë.
Eja në muzg,
ta presim agimin të gëzuar!

Ti je e ëmbël.
Ëmbëlsirë e pakrahasueshme.

Kur zemrat pikëllohen, dil!
Shfaqu si engjëlleshë!
Trego bukurinë që mrekullon!

Eja kurdo!
Je lule që çel në çdo kohë,
Që çel zemrave të hapura.

Mos i thuaj vetes lule!
Mos i thuaj as qershi!
Ti je bukuri e përhershme.
Je luleborë, që dimrin e zbukuron.
Në trishtime, gëzohesh.
Në trishtime je më e dashur.
Godet fqishëm,
Sa e rrëzon hënën mbi ballë.

Kur të kalosh, rrugëve le të hapen dritaret!
Zemrat le t'i shpejtojnë rrahjet!

Hapni dyert, ndoshta fati i saj hyn!
Do të jeni fatlumë.

Mbi tavolinë të qëndisur
çaj me xhenxhefil e trumzë.
Mjalta je vetë.

Ti je kujtim i përjetshëm, je simbol i dashurisë.
Kush të ka ty, e ka përjetësinë.

Buzëqeshja jote shkakton rrufe.
Flakëron dashuri.

JANË KUJTIME
(Trëndafilat)

Ne jemi ndërtuesit e jetës,
ne njerëzit.
Ne jemi realizues së ëndrrave,
jemi njëkohësisht edhe armiq të njëri-tjetrit.
Jemi dy tabore:
njëri tabor mba flamur të bardhë
me simbol dashurie,
tjetri mba flamur të zi me simbol trishtimi.
Vallë, cila këngë do të triumfojë,
ajo e dashurisë apo ajo e urrejtjes?

Ajo vajza mba një trëndafil në dorë.
Ai djali mba një trëndafil në dorë.
Trëndafilat janë pa adresë.
Janë kujtime, se dikur paska patur dashuri.

Kur fillon prapëtia, deti ndizet flakë.
Përrenjtë rrjedhin gjak.
Lakuriqët marrin trajta engjëjsh.
Hëna vdes.
Dielli vritet.
Vajza me trëndafil bëhet hënë.
Djali me trëndafil bëhet diell.
Janë kujtime, se dikur paska patur dashuri.

Qytetet e botës zbukurohen.
Janë mrekullues.
Askush nuk i ndjen mrekullitë e tyre.
Bota e ka humbur shpirtin.
Vajza me trëndafil në dorë bëhet bukuri.
Djali me trëndafil në dorë bëhet dashuri.
Janë kujtime nga kohët e hershme,
se paska patur njerëz me njerëzi.

Dikund shpërthen një vullkan.
Dikund zgjohet një tërmet.
Dikund trazohet deti.
Shumëkush vdes dhe shumëkush lind.
Vdesin të gjallët, lindin të vdekurit.
Vajza me trëndafil në dorë bëhet engjëlleshë.
Djali me trëndafil në dorë bëhet engjëll.
Janë kujtime, se dikur paska patur dashuri.

E PIKTUROJ DASHURINË

Kur hapësirën e vrojtoj natën,
zemra më bëhet galaktikë.

Vegimet më thonë,
se kur isha fëmijë,
kisha qenë xixëllojë, flutur dhe zog.

Në rini. e njoha mjaltin.
E shijova edhe pelinin.
Atëherë i mësova shijet.

Edhe pse kisha orë dore,
kohën nuk e njihja

Jeta ime filloi si shkrepsë e ndezur,
u lëshua mbi ballë si rreze dielli.
U shkrua me shkrim hyjnor.

Tanimë jam stërgjyshi im.
Jam babai im.

Gjithnjë jam pa moshë.
Jam pa kohë.

Këtu vetëm ngarkohem me të mira.
Ngarkohem me të këqia.
Këtu peshoret janë kot,
nuk ka peshore të saktë.
Atje ka peshore të përsosur.
Ka peshore që flet.

Një tingull i ftohtë, më bën akull.
Një tingull i ngrohtë, më bën pranverë.

Në piktura e kam pikturua shpirtin.
Aty janë pranverat e mia.
Aty jeni edhe ju.
Prej jush i marr ngjyrat,
me to e pikturoj dashurinë.

SA S'KA VDEKUR
(Tymi i trurit të shtrydhur)

Në duar të Eskilit, Orestia.
Pika-pika shtrydhet truri.
Ndërgjegjja fërgohet.

Qytete të tymosura blozë ndërgjegjeje.
Pallatet e pikturuar me lëng truror.
Lart, nga oxhaqet shtëllungon tymi,
tymi i trurit të shtrydhur.

O shpëtimtarë, mbroni botën!
Dilni zot jetës!
Drejtësia është përmbysur!
Hudhni lëng drejtësie
sa s'ka vdekur përgjithmonë!

DIÇKA E ÇMUAR MUNGON

Brenga të buta.
Të buta, por brenga janë.

Disi, nuk shkon siç mendojmë ne.
Sikur diçka e çmuar është çrrënjosur,
mungon.

Malli kthehet në brengë, në vuajtje të butë.

Disa korniza mungojnë.
Korniza me fotografi nostalgjike,
që dëshiron t'i kujtosh në heshtje.

Plagët ta prishin shijen.
Shijen e mëngjesit
mu atëherë
kur lulet u gëzohen rrezeve dhe vesës.

Mbyten dy herë: një herë kur grinden,
dhe herën tjetër, kur dashurohen.

Trëndafili mendoi se rrezikohej,
se rrezikonte jargavani,
kurse jargavani, në pranverë i jepte aromë
dhe gjithnjë, gjatë vapës i bënte hije.

JANË KUJTIME QË FLASIN

1.
Brigjeve të detit,
livadheve të shtrira me bar e lule,
kupës së kaltër qiellore,
zemrës së butë...
mund ta përjetoni qartë
se lëndimi është diçka
që nuk i përket dashurisë.
Përpiqem t'i rikthej dashuritë e humbura,
Prandaj tashmë i urrej lëndimet.

Më kujtohet çasti
kur në park,
bri lumit pinim kokakola.
Qeshnim edhe për hiçgjëtë.

2.
Ndër vite valët e ashpra na ndanë.
Stuhitë na i vranë dashuritë.
Janë zjarre që nuk bashkohen,
por që nuk fiken kurrë zemrave.
Digjemi secili flakëve tona.
E keqja lëndon.
Lëndimi vret.
Tanimë e dimë se si ndizen zjarret.

3.
T'i ngjallim të gjithë yjet,
ta ndezim qiellin,
që errësira të zhduket përgjithmonë!
Lëndimi të jetë për qoftëlargët!

Sa e sa të numëroj,
ajo "për herë të parë"
shfaqet vetëm një herë.
Shafqet si hëna e plotë mbi det.
Janë kujtime që flasin,
që tregojnë se parajsa gjendet diku,
diku në qendër të galaktikave të dashurisë.

4.
Nuk dua të shihemi më.
U pamë një herë përjetshëm.
Lundroj buzëqeshjeve tona.
Janë plagë të thella të fikura.
Janë kujtimet rreze dashurishë,
të cilat rrezatojnë kujtimeve.

Edhe pse i tërbuar,
nga mrekullia e syve tu,
arrij të mbijetoj përpbrenda botës,
që di të lëndojë,
të godasë.

ENGJËLLORE

Me atë pamje engjëllore,
sikur lule në saksi;
si Borëbardha përrallore -
të mahnitshëm ata sy.

E vdekura me ty ngjallet,
jeta merr tjetër kuptim;
të kanë zili shtojzovallet,
e mposht çdo trishtim.

SA TË MIRË JENI

Ndjenjat e juaja të thyera në copëza,
m'i trazojnë copëzat e mia.
Buzëqeshja më bëhet grimca.

Edhe pse të trazuar,
ju e gjeni shtegun te buzëqeshja,
kurse unë nuk mund të formoj buzëqeshje.

Sa i keq jam, sa të mirë jeni.

EJA KRAHËHAPUR

1.
Mëngjes.
Akti ka filluar qysh në agim.
Lajmi i kobshëm mbrëmë u dha në glob.
Disa trishtohen, disa gëzohen.
Të dashuruarit e shtrëngojnë njëri-tjetrin,
sepse dita është fat i mirë i tyre.
Festojnë.

2.
Këmbanat nuk do të bien më.
Të trishtuarit do të ikin nga njëri-tjetri.
Nuk do të gjejnë vende për ngushëllim.
Nuk do ta shohin hënën.
Do t'i shkulin flokët e veta.
Rrobat do t'ua marrë furia e mëkateve.
Nuk do të vlejnë as sa sorrat e ngordhura.

Virgjëreshat do ta shijojnë dashurinë.
Në ato çaste nuk do të ketë virgjëresha.
Nuk do të ketë as dashuri.
As njeriu nuk do të jetë njeri.

3.
Eja krahëhapur!
Edhe ne i kemi hapur krahët.
Të dashuruarit kanë vula dashurie.
Të shpëtuarit kanë vula shpëtimtarësh.
Të humburit kanë vula mizorësh.

4.
Eja krahëhapur!
Le të fillojë dashuria e përjetshme!
Njerëzit do të rreshtohen në dy rreshta.
Do të nisen në rrugë të kundërta.
Çdokush do të jetë në rrugën e merituar.

5.
Eja krahëhapur!
Që moti e kemi shpallur dashurinë.

SHTEGUT T'LIRIS'
(Migjeniane)

Për fatkobin tuaj po vdes.
S'më shëron mua spitali,
Shnetin tem e mba lumtunia e juej.

Ju s'më keni faj, o të dashnit e mi!
Unë po vritem prej padrejtsisë
dhe nga kurthet e tyre që m'pengojnë
me e shpërnda lirinë mes jush.

Besoj se vjen dita,
kur ky grusht i jem i vogël bahet diell i juej.
Besoj se do të lind ai agim
nga do të shndrisin vegimet e mia.

Unë po vdes, o popull!
Po vdes
me diellin e lirisë në krahnuer,
kurse juve
po ua la amanet Poemën teme.

Në të do t'i keni shtigjet e lirisë.
Në të do ta keni dritaren
nga do të shihni dritë,
nga do ta shihni sa e madhe,
sa e pasur, sa e bukur
e sa e dashtun asht' liria.

NUK ËSHTË ENIGMË

Pse vijmë në këtë botë?
Pse vijmë në jetë?
Po pse shkojmë?!
Ku është çelësi i këtyre?

Nuk është enigmë,
prandaj mbillni dashuri
dhe vepra me yje,
me diell e me shpirt!

Ndoshta ky është çelësi,
mbase shpirti shtegton.

E DI SE MË DO

1.
Pranvera do të vijë.
Këtë gjithkush e di.
Po, a ka ndonjë, që s'e do?
Çdokush do të jetë në zemrën e saj.
Ajo ka nevojë për ju.
Pranvera vjen e shkon.
Shpirtrat e ftohur i ngroh.
U jep dashuri luleqershie.

Ajo i hap krahët.
Heshtas, me buzëqeshje u flet:
- Ejani te unë, o të dashur, ejani!
Dhe ju vraponi drejt saj.
Ajo u mbështjell me lule.
U derdh nëpër zemra diell.

Në pranverë vegojnë ngjyrat.
Sytë marrin ngjyra lulesh.
Zemrat i përkëdhelin vjollcat.
Dëgjohen këngë të bukura zogjësh.
Shpirtrat bëhen refrenë këngësh.

A ka ndonjë, që s'e do pranverën?
Ajo do, të dashurohi në të.
Ajo do, ëndërrat t'i keni pranvera.

Kur pranvera të shkojë, ta qani!
Për t'i patur ato përherë,
mbani në zemër!

Kur do t'u marrë malli,
ajo do të dalë nga mali.

2.
E di se ajo më do.
Edhe unë s'i ndahem asnjëherë.
Ditë e natë pëshpëris:
- Pranverë, pranverë, pranverë...

BIOGRAFI

Berzat Sadiki u lind më 06. 04. 1962 në Cerovë të Tetovës. U shpërngul në Uzurmisht, ku e kaloi fëmijërinë dhe rininë. Jeton në Tetovë.
Ka të kryer Fakultetin Filologjik - Gjuhë dhe letërsi maqedone dhe pret të diplomojë magjistraturën në Institutin për gjuhë maqedone ”Krste Misirkov” - drejtimi Maqedonistikë me komunikologji. Punon në arsim.
Ka filluar të botojë që nga viti 1975 nëpër revista dhe gazeta në Maqedoni dhe në Kosovë. Në vitin 1983 është çmuar me vendin e dytë në “Takimet e 21-ta të poetëve të rinj në Maqedoni”.
Themelues i Shtëpisë botuese MIRËSIA.
Ka botuar revistat: Argumenti, Mirësia, Shkollari, Klubi i fëmijëve.
Merret me poezi
për fëmijë dhe të rritur. Pjesëmarrës nëpër takime letrare. Fitues i çmimeve dhe lëvdatave.
Berzat Sadiki është kryetar i Shoqatës së shkrimtarëve "Pro litera" në Tetovë.

PËRMBAJTJA

DO TË SHFAQET 5
RIMAT DIELLORE 6
AH, SA DUA 7
FLISNI PËR DASHURI 8
MA TRAZOJNË SHPIRTIN 10
HYNY KU UA DO ZEMRA 13
KOKË NJERIU, MENDJE DJAJSH 14
NUK GJEJ RRUGË 17
KUMTIM PËR DASHURI 18
VJOLLCAT 19
ÇANTAT TUAJA 20
PARA SYVE 21
TË DONI 22
E MAS MËNGJESIN 23
GJUHA E LUMIT 24
NËSE DONI 25
MIQ TË E MIRË 26
KURBETI 27
KUJDESUNI PËR MENDJEN 28
NËPËR TREGJE. 31
ME GRUSHT E ME ZEMËR 32
TË VJETRA 34
DO TË QESHNI NDONJËHERË 35
XHEPAT E ZEMRËS 36
BATISËN NË LLAÇ 37
MOS MË PYET TANI 38
PA NDARË SHIKIM 39
DALLGËVE TË DASHURISË 40

TRËNDAFIL TË MË KESH 41
POEZI E PRAPTË 42
FOL 43
FLAKËRON DASHURI 44
JANË KUJTIME 46
E PIKTUROJ DASHURINË 48
SA S'KA VDEKUR 50
DIÇKA E ÇMUAR MUNGON 51
JANË KUJTIME QË FLASIN 52
ENGJËLLORE 54
SA TË MIRË QË JENI 55
EJA KRAHËHAPUR 56
SHTEGUT T'LIRIS' 58
NUK ËSHTË ENIGMË 59
E DI SE MË DO 60
BIOGRAFI 62

CIP - Каталогизација во публикација Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

821.18(497.7)-1

SADIKI, Berzat
Eja krahëhapur : poezi / Berzat Sadiki. - Tetovë : Pro litera, 2025 (Tetovë : Art frafik). - 64 стр. ; 21 см

Белешка за писателот: стр. 62

ISBN 978-608-66988-4-3

COBISS.MK-ID 65820933